



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

Nr. _____ Prot.

Patos, më ____ .10.2025

ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIT

14.10.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE) “NGRACAN 1934” shpk me NUIS J87602809S, me adresë: Lagjja "Sheq i Madh", Rruga "Koçi Papuçiu", Banesë Private Nr. 53, Fier

Tipi i Kontratës: Kontratë furnizimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës: REF-59716-08-28-2025

LOTI II: REF-59752-08-28-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pjesë këmbimi për pompat”

LOTI II: “Blerje pjesë këmbimi për jet-pompat”

Kohëzgjatja e kontratës: Loti II 7 muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 29.08.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr. 47 datë 1 Shtator 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë ofertuesi i mëposhtëm:

PËR LOTIN II:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ALGEN INVEST” shpk me NUIS K82525406E dhe “NOVAMAT” shpk me NUIS K81615002O, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 8,699,080 lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “NGRACAN 1934” shpk me NUIS J87602809S, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 8,995,000 lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “VIBTIS” shpk me NUIS L02103503S, ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 9,326,800 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ALGEN INVEST” shpk me NUIS K82525406E dhe “NOVAMAT” shpk me NUIS K81615002O, nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:
 - *Kontratat dhe Faturat e paraqitura nga operatori “Algen” shpk pjesë e BOE nuk konsiderohen të ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Kontratat e paraqitura kanë si objekt punët ndertimore, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.1 të pikës 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”*
 - *BOE nuk ka paraqitur formularin e listës së çmimeve sipas shtojcës 3 në DST.*
 - *BOE nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 9001:2015 ose të përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) për O.E “Algen” shpk, kjo në kundërshtim me nenin 88 pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*
 - *BOE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi. Në autorizimin e paraqitur prodhuesi deklaron se prodhon [pompa me piston me presion të lartë dhe pjesë këmbimi] por jo “pjesë këmbimi për jet-pompat” të cilat janë objekt prokurimi i këtij LOTI. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3 të pikës 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 8, LOTI 2, të DST-së.*
 - *BOE nuk ka paraqitur katalog teknik/skede teknike, të prodhuesit, për artikujt objekt prokurimi. Katalogu i paraqitur është gjithashtu i prodhuesit i cili deklaron se prodhon [pompa me piston me presion të lartë dhe pjesë këmbimi] por jo “pjesë këmbimi për jet-pompat” të cilat janë objekt prokurimi i këtij LOTI. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.4 të pikës 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të Shtojcës 8, LOTI 2, të DST-së.*
 - *Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “NGRACAN 1934” shpk me NUIS J87602809S, me adresë: Lagjia "Sheq i Madh", Rruga "Koçi Papuçiu", Banësë Private Nr. 53, Fier, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8,995,000 (tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

* * *

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA